

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve

Fondi 2

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në neto pasuritë	6
Pasqyra e rrjedhës së parasë	7
Shënimet për pasqyrat financiare	8-19

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e “Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a.” – Fond 2

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a (“Fondi 2”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në neto pasuritë dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit 2 me datën 31 dhjetor 2022 dhe performancën e saj financiare dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’ në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që në gjykimin tonë profesional ishin me rëndësi më të madhe në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë për to dhe ne nuk ofrojmë një opinion të veçantë për këto çështje. Çdo çështje e auditimit dhe përgjigja jonë përkatëse përshkruhen më poshtë.

Çështja kryesore e auditimit	Si u trajtua çështja në auditimin tonë
<p>Vlerësimi dhe ekzistenca e pasurisë financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet të fitimit dhe humbjes.</p> <p>Më 31 dhjetor 2022, Fondi mbante pasuri financiare të klasifikuara me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në shumën prej EUR 333,198 (31 Dhjetor 2021: EUR 263,058) dhe përfaqësonin 62% të totalit të pasurive.</p> <p>Shpalosjet e mëtejshme të pasurive financiare përfshihen në shënimet 6 ,12 dhe 13 të pasqyrave financiare.</p> <p>Kjo ishte një fushë e fokusit dhe një fushë ku u drejtuan përpjekje të konsiderueshme të auditimit.</p>	<p>Ne kemi përformuar punën e mëposhtme në lidhje me këtë rrezik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Verifikimi i informacionit të dhënë në konfirmimin e mbajtësve të pasurive financiare sa i përket balancave përkatëse të llogarisë dhe pajtimit të vlerave të raportuara në pasqyrën e pozicionit financiar me të dhënat përkatëse të kontabilitetit. • Për pasuritë financiare të mbajtura me vlerën e drejtë, ne kemi kontrolluar yield-et hyrëse të përdorura për të llogaritur vlerën e drejtë dhe kemi kryer llogaritje të pavarura. • Ne kemi kontrolluar mjaftueshmërinë e shpalosjes të fondit në lidhje me pasuritë financiare.

Informata të tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacione të përfshira në raportin vjetor 2022 të Fondit, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin e auditorit tonë në të. Raporti vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionin tjetër dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë të sigurisë në të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër të identifikuar më lart kur të bëhet i disponueshëm për ne dhe, duke bërë kështu, konsiderojmë nëse informacioni tjetër është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose përndryshe duket se është paraqitur gabimisht.

Kur të lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ekziston një gabim material në të, na kërkohet të komunikojmë çështjen me ata që ngarkohen me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar aktivitetin në vijimësi, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vijimësinë e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (vazhdim)

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Fondit. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisje, ndër çështje të tjera, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara gjatë auditimit, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu u sigurojmë atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen me një deklaratë që ne kemi respektuar kërkesat etike përkatëse në lidhje me pavarësinë, dhe për të komunikuar me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që mund të mendohet se kanë të bëjnë me pavarësinë tonë, dhe kur janë të zbatueshme, veprimet e ndërmarra për të eliminuar kërcënimet ose masat mbrojtëse të aplikuar.

Nga çështjet e komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisje, ne përcaktojmë ato çështje që kishin më shumë rëndësi në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për këtë arsye janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit, përveç nëse ligji ose rregulloret pengojnë zbulimin publik në lidhje me çështjen ose kur, në rrethana jashtëzakonisht të rralla, ne përcaktojmë se një çështje nuk duhet të komunikohet në raportin tonë sepse pasojat e pafavorshme të bërjes së kësaj çështje publike do të pritej në mënyrë të arsyeshme tejkalojnë përfitimet e interesit publik të një komunikimi të tillë.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

Ne u emëruam nga aksionarët në mbledhjen e datës 31 Mars 2022 për të audituar pasqyrat financiare të Fondit Sllaveno Kosovar të Pensioneve Sh.A - Fond 2 për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2022. Angazhimi ynë i pandërprerë është pesë vjet.

Ne konfirmojmë që opinionin ynë i auditimit për pasqyrat financiare të shprehura këtu është në përputhje me raportin shtesë për personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

20 shkurt 2023

V Hamiti

Valbona Hamiti

Auditor Ligjor

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FOND 2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	Më 31 Dhjetor 2022	Më 31 Dhjetor 2021
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	84,385	71,598
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	5	120,568	254,479
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet paqyres së të ardhurave	6	333,198	263,058
Të arkëtueshmet		841	224
GJITHSEJ PASURITË		538,992	589,359
DETYRIMET DHE FONDET E PJESËMARRËSVE			
Detyrime afatshkurtra ndaj klientëve		583	608
Detyrimet ndaj menaxhmentit	9	6,347	6,413
GJITHSEJ DETYRIMET		6,930	7,021
FONDET E PJESËMARRËSVE			
Pasuritë neto të Fondit 2		519,369	569,513
Rezerva teknike	7	12,693	12,825
GJITHSEJ FONDET E PJESËMARRËSVE		532,062	582,338
GJITHSEJ DETYRIMET DHE FONDET E PJESËMARRËSVE		538,992	589,359

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve Sh. a - Fondi 2 më 16 Shkurt 2023 dhe nënshkruar në emër të tij nga,

Mr. Bajram Bajrami,
 Drejtor menaxhues

Fatbardhe Kaqanolli
 Kontabilliste e Çertifikuar

FONDI
 SLOVENO-KOSOVAR
 I PENSIONEVE

Pasqyra e mësipërme e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri 14.

Ky raport është përkthim i versionit origjinal në gjuhën angleze, në rast mospërputhjeje midis këtyre raporteve, raporti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FOND 2
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	2022	2021
TË ARDHURAT			
Të ardhurat nga interesi	8	11,649	12,115
Ndryshimi neto i vlerës së drejtë të pasurive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes		(1,487)	2,435
NETO TË ARDHURAT		10,162	14,550
SHPENZIMET			
Zhvlerësimet		(348)	51
Alokimi i shpenzimeve teknike		(9,814)	(14,601)
GJITHSEJ SHPENZIMET		(10,162)	(14,550)
Neto Teprica		-	-

Pasqyra e mësipërme e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri 14.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FOND 2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË NETO PASURITË**

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	2022	2021
Neto pasuritë më 1 Janar		569,513	595,278
Rritja (Zvogëlimi) e neto pasurive të pjesëmarrësve për vitin		-	-
Kontributet e pjesëmarrësve		260,373	244,754
Pensionet epaguara		(314,116)	(274,711)
Rezerva teknike shpërndarë për pjesëmarrësit	7	3,599	4,192
Gjithsej zvogëlimi neto i pasurive		(50,144)	(25,765)
Neto pasuritë më 31 Dhjetor		519,369	569,513

Pasqyra e mësipërme e ndryshimeve në neto pasuritë duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri 14

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FOND 2
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	2022	2021
RRJEDHJET E PARAVE NGA AKTIVITETET OPERATIVE			
Blerja e mjeteve financiare		(131,217)	(69,895)
Të ardhurat nga shitja e pasurive financiare		190,000	60,000
Interesi i marrë		14,802	9,792
Tarifat e investimit të paguara		-	(4,314)
Tarifat operative të paguara		(6,739)	-
Paratë e gjeneruara nga aktivitetet operative		66,846	(4,417)
RRJEDHJET E PARAVE NGA AKTIVITETET FINANCUERE			
Të ardhurat nga kontributet		263,973	244,754
Pagesat për pjesëmarrësit		(318,032)	(275,075)
Net cash used in financing activities		(54,059)	(30,321)
NDRYSHIMET NË PARA TË GATSHME DHE EKVIVALENTËT E PARASË			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës		71,598	106,336
PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND TË PERIUdhËS	4	84,385	71,598

Pasqyra e mësipërme e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri 1

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme

Fondi i Slloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tutje referuar si "Kompania" ose "Fondi 2") është themeluar si shoqëri aksionare më 29 Gusht 2006 me numër regjistrimi të biznesit 70378739. Kompania ka filluar veprimtarinë e saj më 4 Shtator 2006. Zyra e regjistruar ndodhet në Rr. Ukshin Hoti, nr.45/10, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Fondi 2 administrohet dhe menaxhohet nga Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve sh.a. Aksionarët kryesorë të Kompanisë janë Prva Group PLC, e cila është themeluar në Slloveni me pronësi të 67.4% të aksioneve dhe Korporata Dukagjini në Kosovë me 32.6% të aksioneve. Kompania e fundit amë është kompania sllovene A-Z Finance d.o.o.

Aktiviteti kryesor i Fondit 2 është pagesa e përfitimeve pensionale të kontribuesve të transferuar nga Fondi 1 pas moshës së pensionit, dhe menaxhimi i Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës J.S.C të skemës së pensionit vullnetar.

2. Politikat e rëndësishme e kontabilitetit

Politikat kryesore të kontabilitetit të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

Bazat e Përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të dala nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur politikat e rëndësishme të kontabilitetit dhe bazat e matjes të përmbledhura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse caktohet ndryshe.

Këto pasqyra financiare duhet të lexohen ashtu siç janë përgatitur në përputhshmëri me standardet dhe rregulloret e kontabilitetit. Gjithashtu, kërkon që menaxhmenti të vlerësojë procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit.

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, monedha e Bashkimit Evropian.

Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Fondi ka miratuar të gjitha standardet dhe interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('IASB') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Miratimi i këtyre standardeve dhe interpretimi nuk pati ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të fondit.

Standardet dhe ndryshimet e reja të mëposhtme hynë në fuqi më 1 Janar 2022:

- Referenca në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)
- Covid-19 – Koncesionet e Qirasë përtej 30 Qershorit 2021 (Ndryshime në SNRF 16)
- Kontratat e vështira – Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Pasuritë afatgjata materiale, impiantet dhe pajisjet: të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF - Cikli 2018-2020 (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK)

Standardet dhe interpretimet e lëshuara por akoma jo efektive

Janë lëshuar disa standarde dhe interpretime të reja të kontabilitetit që nuk janë të detyrueshme për periudhat e raportimit të 31 Dhjetorit 2022 dhe nuk janë miratuar herët nga fondi. Këto standarde nuk pritet të kenë një ndikim material në njësinë ekonomike në periudhat aktuale dhe të ardhshme të raportimit dhe në transaksionet e parashikueshme në të ardhmen

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politikat e rëndësishme e kontabilitetit (vazhdim)

Pasuritë financiare

Klasifikimi

Kompania ka klasifikuar pasuritë e saj financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes:

- ato që duhet matur më pastaj me vlerë të tregut (qoftë përmes OCI ose përmes fitimit ose humbjes), dhe
- ato që duhet matur me kosto të amortizuar.

Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhim të pasurive financiare dhe kushteve kontraktuale të rrjedhës së parasë. Kompania riklasifikon investimet e borxhit atëherë dhe vetëm atëherë kur modeli i saj i biznesit për menaxhimin e këtyre pasurive ndryshon.

Njohja dhe mosnjohja

Blerjet dhe shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në datën e tregtimit, datën në të cilën shoqëria angazhohet të blejë ose shet pasurinë. Mosnjohja e pasurive financiare atëherë kur të drejtat për të pranuar rrjedhën e parasë nga pasuritë financiare ka skaduar ose ato janë transferuar dhe shoqëria kryesisht ka transferuar të gjitha rreziqet nga e drejta e pronësisë.

Matja

Gjatë njohjes fillestare, Kompania mat një pasuri financiare me vlerë të saj të tregut plus, në rastin e një pasurie financiare me vlerë jo të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL), koston e transaksionit të ndërlidhura drejtpërdrejt me blerjen e pasurisë financiare. Koston e transaksionit të pasurive financiare të mbajtura në FVPL janë paraqitur në fitim ose humbje.

Pasuritë financiare me derivativat e lidhur merren në konsideratë si tërësi, për të përcaktuar nëse rrjedhën e tyre të parasë e përbëjnë vetëm pagesa e kryegjësë dhe interesit.

Instrumentet e borxhit

Matja e mëpasshme e instrumenteve të borxhit varet nga modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e pasurisë dhe karakteristikat e rrjedhës së parasë së pasurisë. Ekzistojnë tre kategori të matjes, përmes së cilave kompania i klasifikon instrumentet e saj të borxhi:

- **Kosto e amortizuar:** Pasuritë që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ku ato flukse monetare përfaqësojnë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesat maten me koston e amortizuar. Të ardhurat nga interesi nga këto aktive financiare përfshihen në të ardhurat e financave duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Çdo fitim ose humbje që vjen nga mosnjohja njihet drejtpërdrejt në fitim ose humbje dhe paraqitet në fitime / (humbje) të tjera së bashku me fitimet dhe humbjet në valutë. Humbjet nga zhvlerësimi paraqiten si zë i veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021, aktivi financiar me kosto të amortizuar dhe mjete monetare dhe ekuivalente me para klasifikohet në këtë kategori.
- **FVOCI:** Pasuritë që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për shitjen e pasurive financiare, ku flukset e mjeteve monetare të pasurive përfaqësojnë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit, maten në FVOCI. Lëvizjet në vlerën kontabël bëhen përmes OCI, përveç njohjes së fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi, të ardhurave nga interesi dhe fitimeve dhe humbjeve nga këmbimi valutor të cilat njihen në fitim ose humbje. Kur aktivi financiar çregjistrohet, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në OCI riklasifikohet nga kapitali në fitim ose humbje dhe njihet në fitime / (humbje) të tjera. Të ardhurat nga interesi nga këto aktive financiare përfshihen në të ardhurat e financave duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Fitimet dhe humbjet në valutë të huaj paraqiten në fitime / (humbje) të tjera dhe shpenzimet nga zhvlerësimi paraqiten si zë i veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 nuk ka asete financiare të klasifikuara në këtë kategori.
- **FVPL:** Pasuritë që nuk plotësojnë kriteret për koston e amortizuar ose FVOCI maten me FVPL. Një fitim ose humbje nga një investim borxhi që më pas matet me FVPL njihet në fitim ose humbje dhe paraqitet neto brenda fitimeve / (humbjeve) të tjera në periudhën në të cilën lind. Më 31 dhjetor 2022, aktivi financiar me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes klasifikohet në këtë kategori.

Zhvlerësimi

Kompania vlerëson mbi bazën e ardhshme humbjen e pritshme të kredisë të lidhur me instrumentet e saj të borxhit të mbartur me kosto të amortizuar dhe FVOCI. Metodologjia e zhvlerësimit e aplikuar varet nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politikat e rëndësishme e kontabilitetit (vazhdim)

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, që përbëjnë bilancet me bankat për pagesa të kontributeve pensionale dhe për qëllime investimesh, mbarten me kosto.

Të arkëtueshmet dhe detyrimet që lidhen me letrat me vlerë të investimit

Llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet lindin nga blerja dhe shitja e investimeve dhe njihen si pasuri dhe / ose detyrime në datën e transaksionit të bërë.

Neto pasuritë e Fondit 2

Vlera neto e pasurive të Fondit është e barabartë me gjithsej pasuritë minus detyrimet e përgjithshme të Fondit 2.

Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë të ardhura nga normat e kuponit të obligacioneve dhe interesi i depozitave me afat. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në bazë akruale.

Të ardhurat nga dividenda

Dividentat njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse atëherë kur përcaktohet e drejta e Fondit për të pranuar pagesën.

Shpenzimet për tarifën e transaksionit

Këto shpenzime kanë të bëjnë me tarifën e paguara për ndërmjetësit financiarë (bankat dhe shtëpitë e brokerave) të cilët po fitojnë investime për Fondin 1.

Fitimet / humbjet e realizuara

Fitimet / humbjet e realizuara lindin nga shitja e investimeve, niveli i çmimeve kur investimet fitohen dhe maturohen parimet dhe interesi i investimeve të blera me prime ose zbritje. Këto fitime / humbje janë regjistruar realizuar në pasqyrën e fitimit dhe humbjes Linja neto e vlerës së vlerës së pasurive financiare me vlerë të drejtë, përmes fitimit ose humbjes.

Fitimet ose humbjet që vijnë kur investimet janë shitur ose pjekur janë paraqitur si "të realizuara" në pasqyrën e të ardhurave, ndërsa fitimet ose humbjet që vijnë nga vlerësimi i investimeve ende të mbajtura paraqiten veçmas si "Të përealizuara" në ndryshimet neto të vlerës së drejtë të pasurive financiare me vlerën e drejtë, përmes fitimit ose humbjes.

Amortizimi i zbritjes/primit i letrës me vlerë

Amortizimi i zbritjes/primit të letrës me vlerë është regjistruar përmes të ardhurave / shpenzimeve të shtyra dhe shpenzimeve/të ardhurave akruale. Në momentin kur letra me vlerë është maturuar apo shitur, shuma e amortizuar është transferuar si fitim ose humbje e realizuar kapitale.

Fitimet / humbja nga këmbimi valutor

Transaksionet në valutën e huaj janë regjistruar në pajtueshmëri me normat e vlefshme të këmbimit valutor në datën e transaksionit. Diferencat janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si fitime/humbje.

Diferencat e këmbimit valutor të cilat rrjedhin nga raportimi në datën e vlerësimit të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj dhe diferencës që rrjedhë nga shitja e investimeve, raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të realizuara". Diferencat e këmbimit valutor të cilat rrjedhin nga raportimi në datën e përkthimit të investimeve të mbajtura, raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të përealizuara"

Transaksionet me palët e lidhura

Palët e ndërlidhura përcaktohen si ato palë që kanë kontroll mbi njëra-tjetrën ose kanë një ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëri-tjetrit.

Palët e lidhura me fondin janë Prva Company PLC nga Ljubljana, Sllovenia dhe Korporata Dukagjini nga Peja, Republika e Kosovës, të cilat administrojnë Kompaninë.

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. Vlerësimet dhe supozimet kritike të kontabilitetit

Vlera e drejtë e letrave me vlerë të pakuotuar në tregun aktiv

Vlera e drejtë e letrave me vlerë të tilla të pakuotuar në një treg aktiv mund të përcaktohet nga Fondi duke përdorur burime me reputacion të çmimeve ose çmimet treguese nga prodhuesit e tregut të obligacioneve / borxheve.

Fondi do të ushtrojë gjykim dhe vlerësime mbi sasinë dhe cilësinë e burimeve të çmimeve të përdorura. Kur nuk ka të dhëna të tregut, Fondi mund të vlerësojë pozicionet duke përdorur modelet e veta, të cilat zakonisht bazohen në metodat dhe teknikat e vlerësimit të njohura përgjithësisht si standarde brenda industrisë. Hyrjet në këto modele janë kryesisht rendimente të letrave me vlerë dhe rrjedhje të zbritura të parasë. Modelet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta vlerësohen dhe rishikohen në mënyrë periodike nga menaxhmenti.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. Paraja dhe Ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë të mbajtura në llogarinë rrjedhëse në bankat tregtare.

5. Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Depozitat në banka	120,000	250,000
Interesin e përlogaritur	1,124	4,687
Zhvlerësimi	(556)	(208)
GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE ME KOSTO TË AMORIZUAR	120,568	254,479

Depozitat në Banka Kombetare Tregtare fitojnë interes nga 1.2% deri 2.6% (2022: 0.4% deri 1.35%) në bazë vjetore. Periudha e maturimit të tyre varion nga 1 deri në 4 vite (2021: 2 deri 5 vite).

6. Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes përbëhen nga Bono Thesari të emetuara nga Republika e Kosovës. Për zbulimin e rrezikut të kredisë dhe vlerës së drejtë referojuni shënimeve 12 dhe 13.

7. Rezervat teknike

Rezerva teknike paraqet kthimet shtesë të krijuara nga Fondi, të cilat nuk grumbullohen në neto pasuritë të Fondit, por janë të ndara si rezerva.

Në tabelën vijuese është paraqitur lëvizja e rezervës teknike:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Bilanci fillestar më 1 Janar	12,825	8,829
Pranimi gjatë vitit		
Të ardhura nga interesi dhe të ardhura të tjera	11,649	12,115
Zhvlerësimi	(348)	51
Rivlerësimet	(1,487)	2,435
Përgjegjësia për tarifën e menaxhimit (shiko shënimin 9)	(6,347)	(6,413)
Kthimi i garantuar i kontratave	(3,599)	(4,192)
BILANCI I REZERVES TEKNIKE MË 31 DHJETOR	12,693	12,825

8. Të ardhurat nga interesi

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Të ardhura nga interesi nga investimet në FVPL	8,310	7,382
Të ardhura nga interesi nga investimet me koston e amortizuar	3,339	4,733
GJITHSEJ TË ARDHURAT NGA INTERESI	11,649	12,115

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

9. Tarifa e menaxhimit

Më 31 Dhjetor 2022 tarifa e menaxhimit e lëshuar përmes provizionit teknik është Euro 6,347 (31 Dhjetor 2021: 6,413). Kjo shumë përcaktohet nga menaxhmenti i Kompanisë marrë në konsideratë të gjithë faktorët relevantë të Fondit 2. Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 Fondi 2 u ka dhënë kontribuesve yield 1% në vit dhe kthimi i tepërt njihet si detyrim ndaj kompanisë.

10. Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e lidhura konsiderohen të përfshijnë aksionerë, filiale dhe subjekte kryesore nën pronësinë e përbashkët, kontrollin dhe menaxhimin me Fondin, ose aktivitetet e të cilave Fondi ka një aftësi për të kontrolluar.

Të gjitha transaksionet e Fondeve me palët e lidhura lindin në rrjedhën normale të biznesit dhe vlera e tyre nuk ndryshon materialisht nga termat dhe kushtet që do të mbizotëronin në transaksionet e armëve. Të gjitha transaksionet dhe gjendjet e palëve të lidhura i referohen Kompanisë FSKP dhe menaxherit të pasurisë si më poshtë:

31 Dhjetor 2022	Kompania Prva	Kompania	Fondi 2	Gjithsej
Të arkëtueshmet				
Të arkëtueshmet nga kompania	-	174	-	174
Gjithsej të Arkëtueshmet	-	174	-	174
Detyrimet				
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	6,347	-	6,347
Gjithsej Detyrimet	-	6,347	-	6,347

31 Dhjetor 2021	Kompania Prva	Kompania	Fondi 2	Gjithsej
Të arkëtueshmet	-	-	-	-
Të arkëtueshmet nga kompania	-	159	-	159
Gjithsej të Arkëtueshmet	-	159	-	159
Detyrimet				
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	(6,413)	-	(6,413)
Gjithsej Detyrimet	-	(6,413)	-	(6,413)

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

11. Instrumentet financiare sipas kategorisë

Vlerat bartëse të pasurive financiare dhe detyrimeve të Shoqërisë siç janë njohur në datën e pasqyrave të pozicionit financiar nën rishikim mund të kategorizohen si në vazhdim:

	Në vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	Me kosto të amortizuar	Gjithsej
31 Dhjetor 2022			
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	84,385	84,385
Pasuritë Financiare në VDPA	333,198	-	333,198
Pasuritë financiare me koston e amortizuar	-	120,568	120,568
Të arkëtueshmet e tjera	-	841	841
GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE	333,198	205,794	538,992

	At amortized cost		
Detyrimet			
Detyrimet për tarifën menaxhimit		6,347	6,347
Detyrimet tjera		583	583
GJITHSEJ DETYRIMET FINANCIARE		6,930	6,930

	Në vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	Me kosto të amortizuar	Gjithsej
31 Dhjetor 2021			
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	71,598	71,598
Pasuritë Financiare në VDPA	263,058	-	263,058
Pasuritë financiare me koston e amortizuar	-	254,479	254,479
Të arkëtueshmet e tjera	-	224	224
GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE	263,058	326,301	589,359

	At amortized cost		
Detyrimet			
Detyrimet për tarifën menaxhimit	-	6,413	6,413
Detyrimet tjera	-	608	608
GJITHSEJ DETYRIMET FINANCIARE	-	7,021	7,021

12. Menaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e Fondit janë të ekspozuara ndaj një shumëllojshmërie të risqeve financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e risqeve. Qëllimi i Fondit është që të arrihet një balancë e përshtatshme në mes të rrezikut dhe kthimit për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi punën financiare të Fondit.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Kompanisë janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar këto rreziqe, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve nëpërmjet sistemeve të besueshme dhe të përditësuar të informacionit. Menaxhmenti i Shoqërisë rregullisht rishikon politikat e saj të menaxhimit të rrezikut dhe sistemet për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikatat më të mira në zhvillim.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

12 Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

Rreziku kreditor

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Fondi merr pjesë në ekspozimin ndaj rrezikut kreditor, i cili paraqet rrezikun që një palë e kundërt të shkaktojë një humbje financiare për Fondin, duke dështuar në shlyerjen e një obligimi. Rreziku kreditor është rreziku më i rëndësishëm për aktivitetet biznesore të Shoqërisë. Prandaj, menaxhmenti i Fondit me kujdes menaxhon ekspozimin ndaj rrezikut kreditor. Fondi duhet të jetë në përputhje me rregullat e BQK-së përse i përket llojeve dhe shumave të investimeve në pasuritë financiare.

Lëvizja në kompensimet e humbjeve është paraqitur në tabelën më poshtë:

<i>Zhvlerësimet e lejuara</i>	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Lejimi i humbjeve më 31 Dhjetor	208	259
Rritja e lejimeve për humbje nga kreditë është njohur në fitim ose humbje gjatë vitit	348	(51)
Bilanci i lejimeve për humbje më 31 Dhjetor 2022	556	208

Llogaritja e kompensimeve për dëmtime bëhet në bazë të vlerësimit të kredisë të kompanisë së fundit amë të Bankës Kombëtare Tregtare, megjithëse meqenëse Republika e Kosovës nuk ka vlerësim krediti, llogaritja e lejimeve të zhvlerësimit bëhet duke përdorur vlerësimin e kreditit të vendit të ngjashëm në rajon.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për pasuritë financiare me kosto të amortizuar është:

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Paraja dhe ekuivalentët e saj	84,385	71,598
Depozitat bankare	120,568	254,479
Të arkëtueshmet	841	224
TOTAL	205,794	326,301

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Njësia ekonomike është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në lidhje me investimet në borxh që maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Ekspozimi maksimal në fund të periudhës raportuese është vlera kontabël e këtyre investimeve.

Ekspozimi maksimal ndaj kredisë në 31 Dhjetor 2022 është 333,198 Euro (31 Dhjetor 2021: 263,058 Euro). Keto FVTPL janë letra me vlerë të emetuara nga Republika e Kosovës.

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

12 Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

Rreziku i normës së interesit

Tabela më poshtë analizon pasuritë dhe pasivet e Fondit në maturitetin përkatës bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit deri në datën e maturimit kontraktual që nga 31 Dhjetori 2022 dhe 2021:

31 Dhjetor 2022	Që bartin interes					Që nuk bartin interes Nga 3 deri në 12 muaj	Gjithsej Më pak se 1 muaj
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj		
Pasuritë							
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	-	-	-	-	84,385	84,385
Pasuritë financiare me kosto të amortizuara	-	-	30,197	90,371	-	-	120,568
Pasuritë financiare në FVPL	-	-	30,029	245,954	57,215	-	333,198
Të arkëtueshmet tjera	-	-	-	-	-	841	841
Gjithsej Pasuritë Financiare	-	-	60,226	336,325	57,215	85,226	538,992
Detyrimet							
Detyrime afatshkurtra ndaj klientit	-	-	-	-	-	(583)	(583)
Detyrimet ndaj Kompanisë	-	-	-	-	-	(6,347)	(6,347)
Gjithsej Detyrimet Financiare	-	-	-	-	-	(6,930)	(6,930)
Hendeku në neto rrezikun e interesit	-	-	60,226	336,325	57,215	78,296	532,062

31 Dhjetor 2021	Që bartin interes					Që nuk bartin interes Nga 3 deri në 12 muaj	Gjithsej Më pak se 1 muaj
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj		
Pasuritë							
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	-	-	-	-	71,598	71,598
Pasuritë financiare me kosto të amortizuara	-	-	194,197	60,282	-	-	254,479
Pasuritë financiare në FVPL	-	-	2,331	194,763	65,964	-	263,058
Të arkëtueshmet tjera	-	-	-	-	-	224	224
Gjithsej Pasuritë Financiare	-	-	196,528	255,045	65,964	71,822	589,359
Detyrimet							
Detyrime afatshkurtra ndaj klientit	-	-	-	-	-	(608)	(608)
Detyrimet ndaj Kompanisë	-	-	-	-	-	(6,413)	(6,413)
Gjithsej Detyrimet Financiare	-	-	-	-	-	(7,021)	(7,021)
Hendeku në neto rrezikun e interesit	-	-	196,528	255,045	65,964	64,801	582,338

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

12 Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

Rreziku i monedhës së huaj

Fondi 2 nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut në valutë të huaj pasi pasuritë dhe detyrimet e financave janë në Euro.

Rreziku i likuiditetit

Politika e Fondit 2 është të investojë pasuritë në instrumente financiare me likuiditet në tregjet e ndryshme të kapitalit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar me ligj dhe rregullore. Në procesin e krijimit të portofolit të Fondit, me qëllim sigurimin e një likuiditeti më të lartë, pasuritë e Fondit u investuan në investime të karakterizuara me mundësi të shndërrimit të shpejtë në para dhe ekuivalentë të parave të gatshme. Tabelat më poshtë analizojnë pasuritë dhe detyrimet e Fondit në maturimin përkatës bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit deri në datën e maturimit kontraktor (në Euro).

31 Dhjetor 2022	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Gjithsej
Paraja dhe ekuivalentët e saj	84,385	-	-	-	-	84,385
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	-	-	30,197	90,371	-	120,568
Pasuritë financiare në FVPL	-	-	30,029	245,954	57,215	333,198
Të arkëtueshmet tjera	841	-	-	-	-	841
Gjithsej Pasuritë Financiare	85,226	-	60,226	336,325	57,215	538,992
Detyrimet						
Detyrime afatshkurtra ndaj klientit	(583)	-	-	-	-	(583)
Detyrimet ndaj ndërmarrjes	(6,347)	-	-	-	-	(6,347)
Gjithsej Detyrimet Financiare	(6,930)	-	-	-	-	(6,930)
Hendeku neto i likuiditetit	78,296	-	60,226	336,325	57,215	532,062

31 Dhjetor 2021	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Gjithsej
Paraja dhe ekuivalentët e saj	71,598	-	-	-	-	71,598
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	-	-	194,197	60,282	-	254,479
Pasuritë financiare në FVPL	-	-	2,331	194,763	65,964	263,058
Të arkëtueshmet tjera	224	-	-	-	-	224
Gjithsej Pasuritë Financiare	71,822	-	196,528	255,045	65,964	589,359
Detyrimet						
Detyrime afatshkurtra ndaj klientit	(608)	-	-	-	-	(608)
Detyrimet ndaj ndërmarrjes	(6,413)	-	-	-	-	(6,413)
Gjithsej Detyrimet Financiare	(7,021)	-	-	-	-	(7,021)
Hendeku neto i likuiditetit	64,801	-	196,528	255,045	65,964	582,338

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

13. Vlerat e drejta

Vlera e drejtë paraqet shumën në të cilën një pasuri mund të zëvendësohet ose një detyrim i shlyer në bazë të gjatësisë së krahut. Vlerat e drejta janë bazuar në supozime të menaxhimit sipas profilit të pasurisë dhe bazës së detyrimit.

Instrumentet financiare të paraqitura me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë tregohen në tabelën tjetër. Kjo hierarki në Kompani mbledh pasuritë financiare në tri nivele që bazohen në rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuarra (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë identike ose detyrimet.
- Niveli 2: të dhënat hyrëse të tjera, përveç çmimeve të kuotuarra, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë të gatshme për vëzhgim të pasurisë ose të detyrimit, në mënyrë direkte (p.sh. Çmimet) ose indirekte (p.sh. të bëra nga çmimet) dhe
- Niveli 3: të dhënat hyrëse në pasuri ose detyrim të cilat nuk bazohen në të dhëna të gatshme për vëzhgim të tregut.

Pasuritë financiare që maten me vlera të drejta në Pasqyrën e Neto Pasurisë të Fondit janë sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë, si më poshtë (në Euro).

31 Dhjetor 2022	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Pasuritë				
<u>Pasuritë financiare në FVPL</u>	-	333,198	-	333,198
31 Dhjetor 2021	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Pasuritë				
<u>Pasuritë financiare në FVPL</u>	-	263,058	-	263,058

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vëzhgueshme të tregut dhe mbështeten sa më pak në vlerësimet specifike të njësisë ekonomike. Nëse të gjitha inputet e rëndësishme kërkohen për vlerën e drejtë të një instrumenti janë të vëzhgueshme, instrumenti është përfshirë në nivelin 2. Fondi përdor rendimentet më të fundit të obligacioneve të botuara nga Banka Qendrore e Kosovës për të vlerësuar letrat me vlerë të emetuara nga Republika e Kosovës.

Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta ndaj atyre pasurive dhe detyrimeve financiare që nuk maten në bilanc me vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera bartëse		Vlera e tregut	
	2022	2021	2022	2021
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	84,385	71,598	84,385	71,598
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	120,568	254,479	120,568	254,479
Të arkëtueshmet	841	224	841	224
Gjithsej Pasuritë	205,794	326,301	205,794	326,301
Detyrimet				
Detyrimet e tarifës së menaxhimit dhe detyrimet tjera	6,930	7,021	6,930	7,021
Gjithsej Detyrimet	6,930	7,021	6,930	7,021

Vlera kontabël e llogarive të arkëtueshme dhe vlera kontabël e pagueshme supozohet se përfaqëson vlerat e tyre të drejta. Vlera e drejtë e pasiveve financiare për qëllime të zbulimit vlerësohet duke skontuar flukset e

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 2
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

ardhshme kontraktuale të parave me normën aktuale të interesit të tregut që është në dispozicion të Fondit për instrumente të ngjashëm financiarë. Sidoqoftë, për vendosjet bankare afatshkurtra, nëse normat e interesit janë të krahasueshme me tregun, vlera kontabël është vlerësimi më i mirë i vlerës së drejtë.

14. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka pasur asnjë ngjarje pas datës së raportimit deri në miratimin e këtyre pasqyrave financiare, që do të kërkonin rregullime, ose shpalosje shtesë në këto pasqyra financiare.